



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:144598

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06707755

C.nr.644/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarit individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen juridiko-civile të paditësit Sh. S. nga fsh. B. i Z. K. L., të cilin e përfaqëson Valon Sadiku av. nga Lipjani, me autorizim, ndaj të paditurës Komunës së Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson Behar Krasniqi av. publike, me autorizim, për shkak të kompenzimit të orëve shtesë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.13.12.2024, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datën 14.01.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e precizuar e paditësit Sh. S. nga fsh. B. i Z. K. L. si e **BAZUAR**, si dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtorati i Arsimit në Lipjan, që paditësit në emër të pagës shtesë për punë jashtë orarit t'ia paguaj dhe atë për periudhën nga dt.01.09.2019 deri me dt.30.06.2020 për 52 orë pune jashtë orarit t'ia paguaj shumën prej 327.60-€, për periudhën nga dt.01.09.2022 deri me dt.30.06.2023 për 37 orë pune jashtë orarit t'ia paguaj shumën prej 233.10-€, për periudhën nga dt.01.09.2023 deri me dt.30.06.2024 për 74 orë pune jashtë orarit t'ia paguaj shumën prej 466.20-€, për periudhën nga dt.01.09.2024 deri me dt.31.10.2024 për 16 orë pune jashtë orarit t'ia paguaj shumën prej 100.80-€, apo shumen e përgjithshme prej 1,127.70-€, të gjitha këto me kamat ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit dt.13.12.2024, e deri në pagesën definitive, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 638.40-€, e të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënimin të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Sh. S. nga fsh. B. i Z. K. L., në këtë gjykatë përmes të autorizuares së tij, ka ushtruar padi ndaj të paditurës Komunës së Lipjanit, për shkak të kompenzimit të orëve shtesë.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën në vendin e punës mësues klase në SHFMU "N. B." në B.. Në vitin shkollor 2021/2022, paditësi ka punuar me klasën e dytë. Me kontratën e punës parashihet që paditësi i ka 20 orë pune në javë dhe 20 orë mësimi në javë, ashtu që gjithësej paditësi sipas kontratës së punës i ka 40 orë pune/mësimi në javë. Me nenin 20 par.2 të Ligjit të punës, parashihet se orari i plotë i punës është 40 orë në javë. Në vitin shkollor 2019-2020 (dt.01.09.2019 deri me dt.30.06.2020), paditësi ka punuar me klasën e pestë. Sipas Kurikulës së arsimit që në atë kohë ka qenë në fuqi ka qenë e paraparë që klasa e pestë të i ketë 23 orë mësimi në javë. Për këtë arsye paditësi në këtë vit shkollor i ka mbajtur nga 23 orë mësimi në javë, pra tri orë mësimi në javë më shumë se sa që parashihet me kontratë të punës apo tri orë pune më shumë në javë se sa orari i rregullt i punës, ndërsa për këto orë mësimi apo pune jashtë orarit e paditura nuk e ka kompensuar paditësin me pagë shtesë siç

parashihet me nenin 56 par.2 pika 2.3 të Ligjit të punës (30% në orë të pagës bazë) dhe as nuk i jep ndonjë ditë pushimi sipas nenit 56 par.5 të Ligjit të punës.

Me parashtrësën e dt.21.11.2024 pala paditëse e ka bërë precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë më konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe deklarimeve. Me provat të cilat janë administruara është vërtetuar se për periudhën kontestuse paditësi ka punuar më shumë se nga 20 orë mësimi në javë dhe ka punuar nga 20 orë pune në javë. Gjykatës i ka propozuar që në tërësi ta aprovon në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të paditësit si të bazuar.

Shpenzimet e procedure i ka kërkuar sipas TA-së.

Në të përgjigjur në padi e paditura e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse me arsyetimin se çështjet e kërkuara në padi janë pa bazë ligjore dhe se paditësit janë të punësuar tek e paditura dhe askund në kontratën e punës nuk ceket se punëtori i gëzon këto të drejta dhe paditësja i ka nënshkruar këto kontrata dhe është pajtuar me kushtet e kontratës si dhe detyrimet që i përmban. Poashtu as me Ligjin e Punës i cili rregullon kontestet e punës nuk ceket askund se punëtorëve iu takon kompensime të tilla, andaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të gjitha kundërshtimeve duke i propozuar gjykatës që ta refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar duke u mbështetur në Ligjin e Punës.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave dhe atë me shiqimin dhe leximin e Kontratës së Punës me nr.04-112-813/1548 dt.01.09.2016, me shiqimin dhe leximin e listës së pagave në emër të paditësit, me shiqimin dhe leximin i ekspertizës financiare e dt.18.11.2024 Shaban Sylja, së bashku me vendimin për planin mësimor në arsimin parauniversitar të RKS dt.27.08.2017 ne.162/01D të lëshuar nga MASHT, e të cilat prova gjykata i administroj dhe i vlerësoj në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ku vërtetoi këtë gjendje faktike:

a).Paditësi **Sh. S.** ka themeluar marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU "N. B." në fsh. B. i Z. K. L. si mësues klase me orë të punës prej 40 orë në javë.

b) Për shkak të nevojave të punëdhënësit paditësi është angazhuar punë shtesë dhe atë për periudhën kontestuse nga dt.01.09.2019 deri me dt.30.06.2020 ka punuar 52 orë pune jashtë orarit, për periudhën nga dt.01.09.2022 deri me dt.30.06.2023 ka punuar 37 orë pune jashtë orarit, për periudhën nga dt.01.09.2023 deri me dt.30.06.2024 ka punuar 74 orë pune jashtë orarit si dhe për periudhën nga dt.01.09.2024 deri me dt.31.10.2024 ka punuar 16 orë pune.

c) Për orët e punuara jashtë orarit të punës pra, më tepër se kontrata e punës paditësi nuk është paguar nga e paditura dhe për këtë periudhë shuma që i është dashur ti paguhet është në lartësi prej 1,127.70-€.

Faktet nën a) gjykata e vërtetoi nga kontrata e punës e me nr.04-112-813/1548 të dt.01.09.2016, e lidhur në mes paditësit Sh. S. dhe të paditurës, ndërsa faktet nën b) dhe c) gjykata i vërtetoi nga ekspertiza financiare e ekspertit Shaban Sylja nga Lipjani.

Me dispozitën e nenit 56 par. 1 dhe 2, nënpar. 2.3 të Ligjit të Punës parashifet se “ Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”, dhe se për punën jashtë orarit paguhet 30% më tepër se orët e rregullta të punës.

Me dispozitat e nenit 8 të LMD-së, të R. së Kosovës, parashihet se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Ndërsa me dispozitën e nenit 245 po të njëjtit Ligj parashihet se “Kreditoret në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegjeje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”.*

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e lartcekura gjykata vjen në përfundim se e paditura përkundër kërkesës së bërë nga paditësi nuk ia ka paguar orët jashtë orarit të punës e drejt kjo që parashihet me Ligjin e Punës pasi që i njëjti ka punuar më tepër se orët e rregullta të punës dhe për periudhën kontestuse të cekur si në dispozitiv të aktgjykimit obligimi i të paditurës është në lartësi prej 1,127.70-€, andaj gjykata e detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj punën e kryer jashtë orarit të plotë të punës konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj kundërshtimet e të paditurës të theksuara në përgjigje në padi dhe seancën përgatitore, mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pabazuara me arsyetimin se me dispozitën material të referuara më lartë punëmarrësi ka për detyrë të punojë për orët e rregullta të punës dhe për punët apo orët jashtë orarit të rregullt i takon kompensimi shtesë në pagë dhe meqenëse kjo u vërteua nga provat e përmendura më lartë gjykata e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe e detyroj të paditurën që t'ia kompensoj orët shtesë të punës paditësit.

Vendimi për kamatën ligjore u bazua në nenin 382 të LMD-së.

Meqenëse pala paditëse e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet, gjykata në pajtim me nenin 452 dhe 453 të LPK-së, e detyroj të paditurën që paditësve t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për përpilimin e padisë në shumë prej 104.00-€, për përpilimin e parashtrësës për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 104.00-€, për 2 (dy) seancë gjyqësore të përfaqësuar nga e autorizuar e palës paditëse shumë nga 135.20-€, për ekspertiz financiare në shumë prej 100-€ si dhe në emër të taksës për padi në shumë prej 30.-€ apo shumë e përgjithshme prej 638.40-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për çka është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të dispozitave të lartcekura si dhe nenit 136 të LMD-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN
C.nr.644/22 me dt.14.01.2025

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:144598
Datë: 14.01.2025
Numri i dokumentit: 06707755